

**VENDIM**  
**Nr.665, datë 28.9.2011**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS  
PARALELE TIRANË-VORË (KRAHU I MAJTË)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e të vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës paralele Tiranë-Vorë (krahu i majtë).
  2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
  3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për objekte, me vlerë 29 775 437 (njëzet e nëntë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tridhjetë e shtatë) lekë, për pemë dekorative, me vlerë 843 100 (tetëqind e dyzet e tre mijë e njëqind) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 30 618 537 (tridhjetë milionë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) lekësh.
  4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 235 000 (dyqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
  5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 30 618 537 (tridhjetë milionë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2011, “Zëri investime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.
  6. Shpronësimi të fillojë më 30.9.2011 dhe të përfundojë më 30.12.2011.
  7. Pronarët e objekteve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
  8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat është bërë shënimi përkatës “Konfirmim nga ZVRPP-ja”, në bazë të pikave 6 dhe 7 të këtij vendimi.
  9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
  10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
  11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**